REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
DZ/Nr. Prot. 2-180-2271
Nr. i Faq.
Data 03/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/23
Datë: 31.03.2026

Në bazë të nenit 12,40 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), dispozitave të ligjit Nr.04/L-174 për planifikim hapësinor, dispozitave të ligjit Nr.02/L-26 për token bujqësore si dhe akteve tjera relevante për menaxhimin e tokës dhe zhvillimin rural, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 31.03.2026 nxjerrë:

VENDIM

për inicimin e procedurave për hartimin e planit për menaxhimin e tokave rurale në Komunën e Junikut për periudhën 2026-2030

I. Me këtë vendim inicohen procedurat për hartimin e Planit për menaxhimin e tokave rurale në Komunën e Junikut për periudhën 2026-2030, me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore, mbrojtjes së saje dhe zhvillimit rural.

II. Plani për menaxhimin e tokave rurale do të përfshijë:

- Identifikimin dhe klasifikimin e tokave rurale dhe bujqësore,
- Analizën e shfrytëzimit aktual të tokës,
- Masat për mbrojtjen e tokës bujqësore nga degradimi dhe ndërtimi i pakontrolluar,
- Planifikimi i zhvillimit rural dhe bujqësorë,
- Masat për përmirësimin e infrastrukturës rurale,
- Mekanizmat për monitorim dhe zbatim.

III. Autorizohet Kryetari i Komunës që brenda afatit prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të themelojë Grupin punues për hartimin e Planit.

IV. Drafti i planit për menaxhimin e tokave rurale I nënshtrohet konsultimit publik në kohëzgjatje prej 15 ditësh kalendarike.

V. Grupi i punës është i obliguar që draftin e planit ta përgatisë dhe ta dorëzojë për shqyrtim në Kuvendin Komunal brenda afatit prej 120 ditësh nga themelimi i tijë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPI.,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3.Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
4.Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Hollumi

